

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

PËR PIKË DEPOZITIMI DHE TREGËTIMI ME SHUMICË TË WHITE-SPIRIT (PREPARAT SOLVENT PER HOLLIM E PERPUNIM)



Studio "LOERMA" sh.p.k

Loerma sh.p.k

PËRMBAJTJA

HYRJE Prezantim i shkurtër

SEKSIONI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

- 1.1. Qëllimi dhe karakteristikat fizike të projektit
- 1.2. Kërkesat mbi përdorimin e tokës
- 1.3. Procesi i punës dhe karakteristikat operative të objektit
- 1.4. Mbetjet dhe emetimet në mjedis

SEKSIONI 2 PËRSHKRIMI I VENDIT DHE I MJEDISIT TË TIJ

- 2.1. Popullsia ekzistuese në qytet
- 2.2. Flora, faune dhe habitatet
- 2.3. Tokat, kategoria e tokës gjeologjia dhe morfologjia
- 2.4. Cilësia e tokës
- 2.5. Uji , akuiferet shkarkimet e mundshme ekzistuese
- 2.6. Ajri, cilesia e ajrit, faktorët klimatike
- 2.7. Trashegimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike
- 2.8. Pejsazhi

SEKSIONI 3 VLERËSIMI I NDIKIMEVE

- 1.1. Ndikimet në popullsi
- 3.2. Ndikimet vizuale të aktivitetit në rajonin përreth dhe në pejsazh
- 3.3. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga aktiviteti gjatë funksionimit normal
- 3.4. Nivelet dhe ndikimet e zhurmave të shkaktuara nga aktiviteti
- 3.5. Ndikimet e aktivitetit mbi rrugët dhe transportin lokal
- 3.6. Ndikimet e aktivitetit mbi ndërtesat, thesarin historik dhe arkitektonik,

veçoritë arkeologjike dhe shqetësime të tjera njerëzore

- 3.7. Humbje dhe dëmtime tek habitatet dhe speciet qofshin bimë apo kafshë
- 3.8. Humbje dhe dëmtime në tipare gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike
- 3.9. Ndikime fizike të aktivitete (ndryshimi në topografinë lokale, humbja e stabilitetit të tokës, erozioni i tokës etj...)
- 3.10. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitime në tokë, në vendin e aktivitetit dhe në zonën përreth
- 3.11. Ndikimet e përdorimit të tokës/burimeve
- 3.12. Efektet e aktivitetit mbi drenazhim
- 3.13. Ndryshime në tipare të tjera hidrografike
- 3.15 Ndikime ne hidrologjinë bregdetare dhe grykëderdhjes së lumenjve
- 3.16. Ndikimet e ndotësve, mbetjeve etj në cilësinë e ujit
- 3.17. Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike dhe efekteve mjedisore të vecanta
- 3.18. Erërat që përhapen
- 3.19. Ndikimet nga trafiku (rruga , hekurudha , ajri , uji ,) qe lidhen me projektin .
- 3.20. Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve , ujit , energjise ose burimeve te tjera si pasoj e projektit .
- 3.21. Ndikimet e projekteve të tjera që e shoqërojnë si për shembull rrugët e reja , kanalet e ujrave të zeza , banesat , linjat e energjisë , nafte dhe gazsjellëse , tekekomunikacionit , etj
- 3.22. Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara
- 3.23. Ndikimet sekondare që rezultojnë nga ndërveprimi i ndikimeve të tjera direkte të listuara më sipër

SEKSIONI 4 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

PREZANTIM I SHKURTËR

Vendndodhja: Pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë të WHITE-SPIRIT (preparat solvent për hollim e përpunim) në Shijak, Sallmone, nr.pasurie 19/24 zona kadastrale 3851, Durrës

Pronësia: Sheshi në të cilën kryhet aktiviteti ndodhet në pronësi të shoqërisë "Distileria Durrës 2010" sh.p.k me NUIS L01308507K (kontratë qeraje ndërmjet dy shoqërive

NIPT L914195020

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

Tregëtohen: Karburante e bardhë white-spirit

Sipërfaqja totale e sheshit: Rezervuar Cilindrik Vertikal i Fiksuar 600 Ton

Kapaciteti shitës: Sipas nevojave të tregut.

Loerma sh.p.k

DISA KONSIDERATA BAZË

Ruajtja e mjedisit natyror, gjatë veprimtarisë së njeriut mbi natyrën për zhvillimin ekonomik, përbën sot një problem të mprehtë që lidhet me ekzistencën e jetës së gjallë mbi tokë.

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon harmonizimin e zhvillimit me ruajtjen e mjedisit natyror dhe shfrytëzimin racional të burimeve natyrore duke menduar për të tashmen dhe për brezat e ardhshëm.

Ai perben sot një problem madhor për gjithë njerëzimin në mbarë globin dhe ka vënë në alarm shkencetarët, qeveritë dhe organizatat e shoqërisë civile të të gjitha shteteve të botës për marrjen e masave parandaluese kundër zhvillimit të njëanshëm të pakontrolluar.

Samiti i Rios i vitit 1992, Samiti i Johannesburgut 2002, janë treguesit më të plotë të shqetësimit njerëzor për mjedisin dhe klimen botërore dhe për ndërgjegjësimin e të gjitha qënieve njerëzore mbi rrezikun që i kanoset ekzistencës së tyre nga veprimtaria e pakontrolluar dhe e paharmonizuar e vet njeriut .

Gjithë raporti i përgatitur për vlerësimin e impaktit në mjedis të aktivitetit tregëtar nga shoqëria në fjalë është bazuar dhe merr në konsiderat:

- *Ligjin nr. 10448 dt.14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”*
- *Ligjin nr. 10440 dt.07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.*
- *Ligji Nr. 10 431 datë. 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.*
- *Ligji Nr.10 266, datë 15.04.2010 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8897, datë 16.05.2002 "PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA".*
- *LigjiNr. 10463 datë.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.*
- *Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”.*
- *Ligji Nr. 8897 datë 16.05.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”.*
- *Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”;*
- *Ligji Nr. 138/2013 “PËR BURIMET E ENERGISË SË RINOVUESHME”*
- *V.K.M Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”.*
- *V.K.M Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.*
- *VKM Nr 229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transfektrimin e mbetjeve jo të rrezikëshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.”*
- *V.K.M. Nr. 841, datë 03.12.2014 Për miratimin e rregullores “PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME DRIDHJEN MEKANIKE NË VENDIN E PUNËS”.*
- *V.K.M. Nr. 842, datë 3.12.2014 Për miratimin e rregullores “PËR MBROJTJEN E SIGURISË DHE SHËNDETIT TË PUNËMARRËSVE NGA RISQET E LIDHURA ME ZHURMËN NË VENDIN E PUNËS”*

Ky raport përqendrohet kryesisht në prezantimin e problemeve që hasen gjatë fazave që kalon ky aktivitet, nga faza e shfrytëzimit deri në fazën e mbylljes eventuale të tij dhe në rekomandimin e masave zbutese për pasojat negative që mund shfaqen.

SEKSIONI 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**1.1. QËLLIMI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TË PROJEKTIT**

Objekti është një aktivitet që ka për qëllim depozitimin dhe tregëtimin me shumicë të karburanteve të bardhë (white-spirit preparat solvent përhollim e përpunim).

Ambientet e këtij aktiviteti janë instaluar në një shesh me sipërfaqe 1060 m² impianti i distilimit dhe kaldaja 615 m² estakada e ngarkimit shkarkimit të automjeteve 20 m² godina e zyrave përreth 90 m² godina e shërbimeve të sigurisë 20 m². Ky aktiviteti punon me turne dhe ka akses të hyrjes së makinave me rrugë tokësore të asfaltuara

Skemat e projektimit të stacioneve ka këtë përbërje :

- *Rezervuarët mbitokësorë*
- *Pompat*
- *Mbrojtësat nga zjarri*

1.2 KËRKESAT MBI PËRDORIMIN E TOKËS

Ky aktivitet është ndërtuar në një shesh në pronësi vetiake të shoqërisë “Distileria Durrës 2010” SH.A dhënë me kontratë qeraje shoqërisë “3 B Trading” sh.a me numër repertori 7039 dhe nr. Koleksioni 5387 me sipërfaqe totale 1060 m². Ky shesh ndodhet në Durrës, Shijak Sallmone me numër pasuri 19/24, ZK 3851, në një kuotë fushore 2.5 m mbi nivelin e detit. Mund të themi se territori është i rafshët dhe për ushtrimin e këtij aktiviteti nuk është dashur të priset apo të ndërtohet mbi sipërfaqe toke. Ambjenti rreth aktivitetit është kryesisht arë ose objekte ku kryen aktivitete të llojeve të ndryshme. E gjithë sipërfaqja që zë në total ky objekt, është e shtruar me beton. Gjatë kohës së operimit të objektit nuk krijohen dëmtime për tu theksuar, që mund ta bëjnë si sheshin ashtu edhe objektin të përkuperueshme dhe të papërdorshme për qëllime të tjera, pasi mbetjet dëmtuese, që eventualisht mund të shkarkohen në të janë vetëm një sasi minimale karburantesh dhe sasi vajrash të cilat normalisht, si për arsye ekonomike dhe të tjera mbahen nën kontroll të rrept, por edhe kur dalin në mjedis gjatë furnizimit të automjeteve janë në sasi të konsiderueshme të cilat nuk paraqesin probleme për mjedisin. Edhe në rast se ky aktivitet në një të ardhme për arsye të ndryshme ndërpritet, i gjithë sheshi është plotësisht i përdorshëm për çdo qëllim tjetër qoftë kështu në gjëndjen që është duke i ruajtur sipërfaqet e shtruara, qoftë edhe duke i asgjësuar

ato.

1.3. PROCESI I PUNËS DHE KARAKTERISTIKAT OPERATIVE TË OBJEKTIT

Objekti në fjalë ka proçese pune të thjeshta. Gjithë pajisjet dhe mjetet që përdoren për furnizimin janë të thjeshta. Gjithashtu mund të themi se ky objekt nuk është biznes prodhues, si rrjedhim nuk ka përdorim të lëndëve të para por, ka vetëm depozitim dhe tregëtim me anë të autobotëve të cilët furnizojnë pikat me pakicë të tregëtimit të qytetit.

Përshkrimi i skemës së depozitimit dhe furnizimit me karburant

Pompat



Rezervuarë mbitokësor të stacionit



Në këtë stacion kemi 5 depozita me vëllime 600 T por shoqëria ka marrë me qera dhe operon vetëm një të tillë . Depozitat janë prej llamarinë celiku të butë dhe të përgatitur me saldim. Forma e tyre është cilindrike (ndalohet përdorimi i depozitave me faqe të rrafshta) .

Trashësia minimale e llamarinës është 5 mm. Rezervuarët janë të paisur me kapak (bakaport) të mbyllur me bullona për të lejuar hapjen e tyre për kontroll. Në kapakun e bakaportës hyjnë tubacionet me ngjyr blu dhe ngjyr të kuqe të cilat janë të lidhura me depozitën e ujit dhe të shkumës dhe hapen në rast rreziku për shuarjen e zjarrit. Rezervuarët janë të lyer nga jashtë me material antikoroziv dhe të veshur me material hidroizolues për tu mbrojtur nga korrozioni.



depozitat e ujit



depozitat e shkumës

Tubacionet dhe linjat e tjera që lidhen me rezervuarët plotësojnë këto kushte :

- Të gjitha tubat janë me material të paoksidueshëm , ndalohet përdorimi tubove të zeza .
Lidhësit e tubacioneve kanë konstruksione dhe cilësi të përshtatëshme, konkretisht prej inoksi.
- Tapat e hermetizimit të daljeve nga rezervuari janë me material bronxi, alumini apo bronxi që të evitohen shkëndijat gjatë hapjeve dhe mbylljeve si dhe nga korozioni që shkakton karburanti.
- Tapat e hermetizimit te daljeve nga rezervuari vendosen me filetim ose hermetike me konicitet.



Vendosja e rezervuarëve mbi tokë

- Rezervuarët janë vendosur mbi tokë në formë cilindrike të vendosur në krah të njëri-tjetrit.
- Bazamenti ku vendosen rezervuarët është e shtruar me beton dhe të rrethua me murë me lartësi të vogël
- Depozitat janë vendosur në një distancë të caktuar larg njera - tjeters.
- Mbi çdo rezervuar kemi të vendosur bokaportat në të cilat janë vendosur aksesoret ndihmës të saj .
- Montimi i të gjithë tubacioneve dhe linjave të tjera në rezervuar metalik si dhe pompave të dhënies së karburantit sigurojnë një hermetizim të plotë duke evituar çdo rrjedhje të mundëshme.

1.4. MBETJET DHE EMETIMET NË MJEDIS

Më poshtë jepet një përshkrim i detajuar i mbetjeve dhe shkarkimeve të tyre në mjedis, sipas etapave të procesit, natyrës, sasive të tyre dhe drejtimet në të cilat ato shkarkohen së bashku me efektet e mundshme të dëmshme që mund të krijohen për tani dhe për një të ardhme të largët.

- Tipi dhe sasia e lëndës së parë

Produkti që shitet në këtë pikë është white-spirit.

Karakteristikat e produktit që tregëtohen :




LABORATOR PRODUSE PETROLIERE VEGA

Testing report no:1500085523; date:10/23/2023 9:41:02 AM
(registered copy for customer; Rompetrol Rafinare Rafinaria Vega)

Customer	Rompelrol Rafinare Rafinaria Vega
Sample:	Refined white spirit
Receiving date	10/23/2023 8:00:00 AM
Final date	10/23/2023
Sampling method	SR EN ISO 3170-04/C91:05*
Tank/Lot	B 49
Contract/Order number	CONTRACT RR (Vega) 1/25.04.2023/APPENDIX 2
Sampling place	CB 4489 PA / CB 0167 EA
Sampled by	RQC LPP Vega
Transported with	CB 4489 PA / CB 0167 EA
Sampled sample	1 L
Customer address	Ploiesti, Str. Valeni nr.146
Customer address	

No.	Property	Test method	UM	Required value	Determined value	Uncertainty [#]
1	Density to 15°C	SR EN ISO 12185-03	kg/m ³	max.815	781.8	-
2	Flash point Abel	SR EN ISO 13736-2021/A1:2022	°C	min.30	33.0	-
3	Initial boiling point	ASTM D 86-23	°C	max.165	142.0	-
4	98% (v/v) distill to	ASTM D 86-23	°C	max.220	200.0	-
5	Residue and losses	ASTM D 86-23	%(v/v)	max.2	1.5	-
6	Relative volatility to xylene	SS 102*		min.2 max.4.5	4.5	-
7	Mechanical impurities and water	SS 102*		lipsa[nil]	nil	-
8	Mineral acidity and alkalinity	ASTM D 1093-11(2017)*		lipsa[nil]	nil	-
9	Sulphur content	ASTM D 5453-19a	%(m/m)	max.0.0250	0.0002	-
10	Aromatics	ASTM D 1319-20a*	%(v/v)	max.22	12.2	-
11	SAYBOLT colour	ASTM D 156-15*		min.+20	+26	-
12	Copper strip corrosion test[3h at 100°C]	SR EN ISO 2160-2002*		Clasa 1	1b	-

Remarks:
At customer demand the following was calculated: Density at 15 C degree corrected in air 780.7 kg/m³.



- Nota:
- The Rompetrol Quality Control S.R.L. laboratory is accredited by RENAR for testing activity in compliance with SR EN ISO/CEI 17025:2018 as specified in the accreditation certificate no. U 333. The tests covered by the accreditation are available at www.renar.ro.
 - * The marked tests are not covered by the RENAR accreditation.
 - Expanded Uncertainty of 95% confidence level with coverage factor k=2.
 - The testing report cannot be partially reproduced without explicit written approval of the testing laboratory.
 - The testing results refers to the tested sample and not the entire lot.

ROMPETROL QUALITY CONTROL S.R.L.
215 Navodari Blvd., 2nd floor, room 220, Navodari - Constanta, Postal Code 905700 ROMANIA
Tel: +40.241.50.6700/+40.244.406.178/406.180 | Fax: +40.241.506.916/+40.244.406.338
Email: comercial.rqc@rompetrol.com, www.rqc.ro

- Mbetjet dhe emetimet

Gjyatë periudhës së tregëtimit me shumicë të produktit më sipër janë të pranishme këto mbetje:

- Pluhura të formuara nga lëvizjet e vetë automjeteve që bëjnë të mundur furnizimin e depozitave dhe automjetet që mbushen për të furnizuar pikat e karburantit.
- Gazra të llojeve të ndryshme të emetuara nga automjetet që hyjnë dhe dalin në këtë pikë tregëtimi.
- Shkarkime ujore kryesisht ato sasira që janë të domosdoshme për procesin e lartjes së territorit
- Zhurma të shkaktuara kryesisht nga hyrja dhe dalja e automjeteve në këtë aktivitet.

SEKSIONI 2

PËRSHKRIMI I VENDIT DHE I MJEDISIT TË TIJ

Pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë të karburanteve White-Spirit ndodhet në Shijak, Sallmone, nr.pasurie 19/24 zona kadastrale 3851, Durrës.



Sheshi i ndërtimit kufizohet nga 3 anë me tokë arë dhe nga pamja ballore me rrugën automobilistike

2.1. Popullsia ekzistuese në qytetin e Durrësit

Qyteti i Durrësit aktualisht është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri e populluar me rreth 200.000 banorë. Banorët në këtë zonë janë autoktonë qysh prej shumë vitesh por vitet e fundit nga levizjet demografike ka ndodhur që të kemi dhe një përqindje të ndjeshme të popullsisë me origjinë rurale të ardhur nga fshatra por dhe rrethe të tjera të vendit tonë. Në portin e Durrësit vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të lëvizjes së qytetarëve për në vendet fqinje por dhe të lëvizjes turistike vendas e të huaj. Ky fakt ka bërë që të kemi një rritje të lëvizjeve të mjeteve transportuese të udhëtarëve, gjë që kërkon edhe një shërbim për trajtim mjedisor me të mirë pasi volumet e mbetjeve nga veprimtaria njerëzore është rritur në mënyrë të ndjeshme.

2.2. Flora, faunë dhe habitatet

Durrësi karakterizohet nga një larmi llojesh floristike natyrore por edhe të kultivuara, një larmi shumë të pakt të llojeve faunistike kryesisht shtëpiake e bujqësore si dhe të një shumëllojshmërie morfografike habitatesh. Është në një nivel të lart llojshmëria e gjallesave në mjedisin tokësor e detar e që kërkon sigurimin e një niveli të lartë të kushteve mjedisore . Këta elemente mjedisor të zonës në fjalë përbëjnë një pasuri natyrore ekonomike dhe turistike me vlera të larta. Larmia gjeografike përfshin një larmi habitatesh si ekosisteme me karakteristika specifike floristike e faunistike por që në kompleks është një habitat natyror me vlera të larta mjedisor e për rrjedhim edhe për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për zonën, por njëkohësisht edhe një pasuri me vlerë kombëtare. Ndërrhyrja në kontrollin e këtyre aktiviteteve që po ushtrohen në këtë zonë, e duke patur parasysh mbrojtjen e mjedisit si një ekosistem kompleks nëpërmjet mosdotjes së saj ashtu sic është përshkruar në projektin teknologjik të paraqitur më sipër, nuk con në impakte të nivelit të tjetërsimit të gjeomorfografisë ekzistuese dhe as të impaktit negativ në mjedisin. Sigurisht si çdo ndërhyrje ka dhe impaktin e vet negativ por që ky impakt është në nivele shumë të vogëla, praktikisht zero.

Njëkohësisht nëpërmjet masave për zvogëlimin e ndikimeve negative që zbatohen gjatë këtij aktiviteti bëjmë të mundur që impaktet në gjeomorfologjinë si dhe gjeomorfografinë e kësaj zone të jenë shumë minimale e praktikisht zero. Ruajtja dhe mirëadministrimi i gjeomorfografisë së zonës ku behet ky aktivitet, nuk dëmton në asnjë mënyrë nivelin e tjetërsimit të gjeomorfologjisë e as të gjeomorfografisë së kësaj zone. E gjithë zona dallon për nga diversiteti i habitateve dhe pasuria në specie të florës dhe faunës. Shumë prej tyre kanë një status ruajtje ose janë të rrezikuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe rajonal. Në zonën e aktivitetit mund të themi që nuk ka larmi specie faunistike dhe floristike për arsye se kjo është një zonë e ndërtuar me banesa dhe aktivitete të ndryshme. Mund të themi që qyteti është rang i gjerë habitatesh tipike për zonat ligatinore: shkurre mesdhetare, dhe makia në vargun e kodrave, pyjeve aluviale, zona me ujë. Pasuria e habitateve shpjegon dhe prezencën e një numri të madh specimesh vertebrorësh dhe jo-vertebrorësh të tillë si zogj, gjitarë, zvarranikë, insekte dhe peshq.

Flora

Flora dhe vegjetacioni është shumë e pasur dhe interesante. Për zonën njihen rreth 1,400 vascular plant species (baraz me 42.4% te florës Shqiptare). Të gjitha këto specie bimësh përbëjnë një pasuri të madhe kombëtare. Disa prej tyre janë shumë të rralla, disa të tjera kanë vlera shkencore, një numer i madh i tyre përdoret si bimë mjekësore, aromatike, industriale, ushqimore dhe decorative.

Rreth 25 specie bimësh ose 7.5% të numrit total të specieve bimore të rrezikuara të Shqipërisë (330 specie në total) takohen në kompleksin e ligatinave. Mes tyre, 9 Specie janë të rrezikuara në shkallë lokale ndërsa dy specie janë endemike për Shqipërinë Biodiversiteti i kësaj zone nuk do të dëmtohet nga presionet njerëzore.

Në pikën e magazinimit dhe tregëtimit të karburanteve nuk ka praktika të papërshtashme si shpyllëzim e asnjë lloj tjetër praktike demtuese të cfaredo lloji.

Nuk ka shkaktim të gryerjeve e rrëshqitjes e tokës.

Lidhur me florën e në vecanti të asaj përreth zonës në mënyre të përgjithshme mund të themi se nuk dallohet për një pasuri me vlera të vecanta.

Nga pikpamja e llojshmërisë së faunës konstatohet se përsa i përket gjallesave të invertebrorëve janë po ato të gjithë qytetit, por duhet vënë në dukje se popullata e llojeve invertebrore janë të vogla pasi ky fakt lidhet me parametrat e faktorëve ekologjike që janë më të pafavorshëm pasi kjo gjë është e shkaktuar nga vetë urbanizimi i një qyteti. Larmia e llojeve të vertebrorëve është përsëri relativisht e ulët për faktin se kushtet e shfrytëzimit të tyre është shumë i vogël e kjo për arsye të një qyteti urban. Shumica e faunës paraqitet me popullata të vogla por që urbanizimi i qytetit ndikon direkt në mos mbijetesën e llojeve natyrore dhe në mos mbarështimin e atyre të kultivuara. Përsa i përket popullatave të florës dhe faunës detare themi se ato janë të larmishme e në vecanti të asaj ihtike por se rezervat e këtyre popullatave janë në kufij minimal dhe si pasojë ndikim në to është paraprakisht zero.

2.3. Tokat, kategoria e tokës gjeologjia dhe morfologjia

Dihet se gjendja e tokës është e rëndësishme për bujqesinë për pylltarinë dhe biodiversitetin, dhe nga ana e tyre këto janë të rëndësishëm për ekonominë, shëndetin publik dhe turizmin . Veprimtaria në fjalë nuk kërkon tokë në përdorim për asnjë lloj aktiviteti, por e vetmja sipërfaqe tokësore është ajo e instalimit të tendës, pompave, etj dhe e zyrës së shërbimit. Në sipërfaqen e tij marrin pjesë depozitimet me moshë të Miocenit e Pliocenit, kuaternare detare që përfaqesojnë strukturat e Ultesirës Pranëadriatike të përbëra nga shkëmbinjtë rrënjësore argjilo-alevreolitore, ranor e konglomeratë, që kryesisht janë të përhapur në pjesët anësore të rajonit, kryesisht në lindje të tij.

Gjithashtu marrin pjesë edhe depozitimet Kuaternare që mbulojnë pjesën fushore të rajonit të përfaqësuara nga sedimente detare të Pleistocenit dhe detare e kontinentale të Holocenit.

2.4. Ajri, cilësia e ajrit, faktorët klimatikë

Mund të themi që qyteti i Durrësit ka një klimë mesdhetare të ndikuar nga lartësitë e kodrave përreth duke krijuar një dimër pa reshje dëbore e ngrica me temperatura që nuk zbresin nën zero gradë celsius për një periudhë që shkon nga muaji Dhjetor deri në Shkurt mund të ketë vetëm pak ditë me temperatura që mund të zbresin nën zero.

Vera është e freskët deri në të nxehtë me temperatura mesatare rreth 24 — 26 grade e me pak rreshje. Faktorët klimatikë janë shumë favorizues për biodiversitetin e në vecanti për zhvillimin turizmit detar.

2.5. Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike

Zona ka një paraqitje arkitektonike të larmishme ku dominohet nga ajo fushore me lartësi të kodrave përreth që shkojnë deri në 150 m.

Në zonën që operon shoqëria nuk ka ndonjë trashëgimi historike të vecantë, po kështu mund të themi që kjo zonë nuk shquhet si zonë arkeologjike.

2.6. Pejsazhi

Zona ku kryet aktivitetet nuk ka vlera të mëdha natyrore dhe piktoreske pasi sic e përmendëm edhe më sipër është zonë urbane e rrethuar me ndërtesa dhe aktivitete të ndyshme. Zona nuk ka ndonjë status të vecantë për tu mbrojtur, nuk është zonë e mbrojtur me ligj, nuk është as në rezervat kombëtar natyror, nuk është zonë me bukuri të rrallë natyrore, nuk është park rajonal, as dhe rural nuk është rezervat natyror local, nuk ka ndërtime me vlera, as monumente të lashtësisë të cilat mund të rrezikohen nga ky aktivitet.

SEKSIONI 3

VLERËSIMI I NDIKIMEVE

Ky përfshin efektet direkte dhe indirekte, sekondare, të asimiluara, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përkohëshme dhe të përhershme, pozitive dhe negative të projektit.

-Efektet mbi qëniet e gjalla, ndërtesat dhe tipare të tjera të mjedisit të realizuara nga dora e njeriut

1.1. Ndikimet në popullsi

Aktivitei nuk ndikon në popullsi, për pasojë nuk ka ndikime pasuese mjedisore.

Kjo sepse përreth zonës nuk ka shumë ndërtesa banimi, përveç se veprimtari të tjera të cilat kryejnë aktivitetin e tyre. Gjithashtu aktiviteti nuk shoqërohet me zhurma apo emetime të llojeve të tjera në nivele të larta shqetësuese për banorët. Si ndikim pozitiv përmendim punësimin e një numri të vogël të punonjësve e cila zgjidh minimalisht një nga problemet sociale siç është punësimi.

3.2. Ndikimet vizuale të aktivitetit në rajonin përreth dhe në pejsazh

Nuk ka ndikim negativ në pejsazhin natyror të zonës apo qytetit duke shkaktuar tjetërsime të pjesshme

3.3. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga aktiviteti gjatë funksionimit normal

Pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë e karburanteve nuk është burim i emetimeve në ajër të gazeve që mund të ndotin atmosferën kjo për arsye se të gjitha gazrat që emetohen nga makinat e mëdha që sjellin karburantin dhe të atyre që cojnë karburantin drejt pikave të tregëtimit me pakicë janë brenda normave të lejuara. Nuk ka ndikim mbi atmosferën, përbërjen e saj dhe klimën. Si rrjedhim nuk ndikon në shëndetin e njerëzve, të florës dhe faunës.

Gjatë këtij aktiviteti nuk përdoren lëndë kimike e të ndaluara me ligj, po ashtu as lëndë ozon holluese.

3.4. Nivelet dhe ndikimet e zhurmave të shkaktuara nga aktiviteti

Gjat kryerjes së këtij aktiviteti, ka zhurma që shkaktohen kryesisht nga ardhja dhe largimi i automjeteve por duke qënëse aktiviteti ndodhet në një zonë periferike me aktivitete të ndryshme dhe jo shumë të banuar nuk ndikon në prishjen e qetësisë publike

3.5. Ndikimet e aktivitetit mbi rrugët dhe transportin lokal

Duke qënë se aktiviteti ndodhet në anë të rrugës, në një zonë periferike jo shumë të banuar, dhe numri i makinave që kalojnë është i vogël, mund të themi që ky aktivitet nuk ndikon në rëndimin e trafikut të kësaj zone.

3.6. Ndikimet e aktivitetit mbi ndërtesat, thesarin historik dhe arkitektonik, vecoritë arkeologjike dhe shqetësime të tjera njerëzore

Meqënëse në këtë zonë nuk ka trashëgimi arkitektonike, nuk ka dëmtim të këtij lloji. Mund të përmendim që veprimtaria nuk ka asnjë lloj ndikimi mbi mjediset e ndërtuara nga njerëzit në afërsi të rrugëve duke përfshir ndërtime banimi të komunitetit, monumenteve historike e kulturore, sipërfaqe të gjelbëruar dhe pyje , as dhe zona të mbrojtura me ligj.

3.7. Humbje dhe dëmtime tek habitatet dhe speciet e tjera qofshin bimë apo kafshë

Aktualisht në këtë zonë pemët dhe gjelberimi që ndodhet aty afër nuk janë të prekura nga kryerja e këtij aktivitetit. Kjo për faktin se shoqëria që operon nuk ka aktivitet prodhimi që të shkarkoj mbetje në mjedis, ajo thjesht ka depozitim dhe tregëtim të karburanteve. Ndaj mund të themi që ky aktivitet si teknologji nuk përmban emetimin e gazrave dhe rrjedhjeve, kjo është e mundshme vetëm në qoftë se kemi mos përputhje ose shkatërrim të pjesëve ku lidhen tubacionet me rezervuar si dhe në sektorin e pompave .

Dëmtimi i faunës (fauna shtëpiake) nuk vërehen në aktivitetin depozitues dhe tregëtues të këtij lloj mbasi terreni rreth objektit nuk ndotet nga asnjë lloj shkarkimi qoftë ky material i ngurtë, i lengët apo i gazët.

3.8. Humbje dhe dëmtime në tipare gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike

Ndikimet në gjeologjinë e zonës nuk vërehet sepse lëndet e para nuk ndikojnë në formacionin gjeologjik që përbëjnë bazamentin ku është ndërtuar ky objekt ne sektorin ku operon shoqëria

3.9. Rjedhoja të tjera ekologjike

Nuk ka.

3.10. Ndikime fizike të aktivitete (ndryshimi në topografinë lokale, humbja e stabilitetit të tokës, erozioni i tokës etj...)

Nuk ka ndryshime të topografisë së zonës apo asaj lokale, erozioni ashtu sic është përshkruar edhe më sipër nuk është rritur më shumë se ajo mesatare e vendit tonë që ndodh në rrugë natyrore.

3.11. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitime në tokë, në vendin e aktivitetit dhe në zonën përreth

Pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë e karburanteve gjatë veprimtarisë së saj nuk ka emetime kimike as depozitime të këtij lloji apo të çfardo lloji tjetër me natyrë ndotëse të mjedisit. mjedisit.

3.12. Ndikimet e përdorimit të tokës/burimeve

Nuk ka ndikime në cilësinë e tokës pasi sic është përshkruar edhe më sipër nuk ka asnjë burim të ndotjes. Kjo për arsye se ujrat e papastër që dalin për përdorime higjeno-sanitare që janë dhe të vetme ujra që shkarkon aktiviteti largohen nëpërmjet rrjetit të kanalizimit të qytetit.

3.13. Efektet e aktivitetit mbi drenazhim

Tokat e zonës nuk janë të drenazuara, pra nuk ka dëmtime të kësaj natyre

3.14. Ndryshime në tipare të tjera hidrografike

Si pasoj e ushtrimit të aktivitetit nuk ka ndryshime të nivelit të ujrave nëntokësor dhe të drejtimit të rrugëve të tyre. Kjo për vet faktin se ujrat që dalin nga përdorimi higjeno-sanitar largohen nga kjo shoqëri nëpërmjet sistemit të kanalizimit.

3.15 Ndikime ne hidrologjinë bregdetare dhe grykëderdhjes së lumenjve

Pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë të karburanteve nuk shkakton ndryshime të nivelit të ujrave tokësorë, po kështu as edhe drejtimit të rrugëve të ujrave nëntokesore. Zona që ushtrohet aktiviteti është shumë larg bregdetit të gjirit të Durrësit dhe nuk ka asnjë lloj ndikimi direkt apo dhe indirekt të bregdetit, plazheve dhe të ujrave detare. Nga kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj përpunimi kimik apo biologjik gjatë funksionimit të saj. Gjithashtu nuk ka shkarkime të ujrave të ndotura.

Aktiviteti nuk shkakton ndotje të ujrave lumore apo të ujrave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore as edhe të burimeve të tyre si dhe formimeve akuiferë, as të ujrave detarë.

3.16. Ndikimet e ndotësve, mbetjeve etj në cilësinë e ujit

Nuk ka ndikime duke qënë se nuk ka shkarkime të mbetjeve apo ndotësve në ujë.

3.17. Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike dhe efekteve mjedisore të vecanta

Nuk ka emetime kimike, dhe si rrjedhojë nuk ka ndikime mjedisore.

3.18. Erërat që përhapen

Emetimet në ajër në linja të tilla kostatohen vetëm në rastet e një hermetizimit të keq të paisjeve si dhe një mos funksionim korrekt i sistemit të pompave. I vetmi emetim në ajër është dalja e gazrave nga tubot e ajrimit të depozitave. Sistemi i Alarmit të instaluar në to bën të mundur bllokimin direkt në rast rrjedhjeje. Në këtë lloj aktiviteti nuk ka burime për aroma sulmuese që provokojnë iritim në organizmat e gjalla apo tek njerëzit .

3.19. Ndikimet nga trafiku (rruga , hekurudha , ajri , uji ,) që lidhen me projektin .

Nuk ka.

3.20. Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve , ujit , energjise ose burimeve të tjera si pasojë e projektit .

Nuk ka.

3.21. Ndikimet e projekteve të tjera që e shoqërojnë si për shembull rrugët e reja , kanalet e ujërave të zeza , banesat , linjat e energjisë , naftë dhe gazsjellëse , tekekomunikacionit , etj

Nuk ka.

3.22. Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara

Nuk ka.

3.23. Ndikimet sekondare që rezultojnë nga ndërveprimi i ndikimeve të tjera direkte të listuara më sipër .

Nuk ka.

SEKSIONI 4

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUSIONE

- Gjatë funksionimit kjo pikë depozitimi dhe tregëtimi me shumicë të karburanteve nuk krijon mbetje me natyrë organike e që janë të biodegradueshme.
- Veprimtaria nuk tjetëron sipërfaqe të mjedisit me karakteristika të favorshme për popullime gjallesash natyrore apo të kultivuara.
- Veprimtaria që kryen kjo shoqëri nuk shkarkon në mjedis lëndë të rrezikshme e nuk shkaktohen ndotje nëpërmjet mbetjeve mbi normat e lejuara.
- Veprimtaria që kryen kjo shoqëri, nuk ndikon në përkeqësimin e parametrave optimale të treguesve mjedisor apo klimatik.
- Veprimtaria e kësaj shoqërie nuk ndikon në vlerësimin strategjik mjedisor të zonës kontinentale as dhe të asaj detare me të cilin krijon lidhje indirekte

Bazuar në normat e lejueshme të përcaktuara nga ligjet përkatëse mbi ndikimet në mjedis, projekti i pikës depozitimit dhe të tregëtimit me shumicë të karburanteve nga shoqëria dhe që do ti paraqitet pranë AKM-së për tu pajisur me LEJE MJEDISORE nuk shkakton ndotje të mjedisit pra nuk shkakton :

ndotje të ujit të pijshëm

ndotje të ujrave sipërfaqësore ose të atyre nëntokësore

ndotje të ajrit

ndotje të tokës

tjetërsime të pejsazhit

dëmtime të pyllit nëpërmjet prerjeve

Rezulton se pika e depozitimit dhe tregëtimit me shumicë të karburanteve nga shoqëria:

- nuk dëmton ekosisteme
- nuk dëmton burimet natyrore
- nuk dëmton zhvillimet social – kulturore të zonës ku do të operojë apo të Bashkise ku perfshihet kjo zonë
- nuk do të ketë dëmtim të tokës bujqësore
- nuk rrit dukurinë e erozionit.

REKOMANDIME

Përvec masave të përshkruar gjatë trajtimit të këtij raporti mjedisor është e rëndësishme që subjekti që operonë do të zbatojë :

- Masat tekniko organizative të përshkruara në raportet e VNM- së
- Mbajtjen në gadishmëri të plotë të procesit të furnizimit me lëndët që tregëton, kjo për vet faktin se janë lëndë të rrezikshme
- Të kryhen kontrollet e nevojshme të emetimeve dhe të kryhen analizat përkatëse për të përcaktuar nivelin e ndotjes për cdo lloj shkarkimesh dhe emetimesh në mjedis nga mjetet dhe pajisjet teknologjike që përdor kjo veprimtari.
- Të aplikohen masa të llojit estetik dhe ekologjik të përshtatshme, të parashikuara qysh në raportin e VNM-se duke nënkuptuar elemente të tilla si formim pejsazhi të ri të zonës së grumbullimit të mbetjeve urbane në harmoni me mjedisin, krijim të brezave apo të sipërfaqeve të mbjella me bimësi karakteristike të zonës apo bimë të kultivuara, ruajtja e mundshme e habitateve apo dhe krijimi i habitateve të reja e në harmoni me mjedisin .
- Të zbatojë me korrektësi të gjitha kushtet që do të vendosen në lejen e mjedisit nga AKM

